



VËZHguesi



-BIZNES-



**KOALICIONI I
BIZNESIT
KUNDËR
KORUPSIONIT
KORÇË**



-BIZNES-

NË KËTË NUMËR TË “VËZHguesIT” DO TË LEXONI:

 **USAID** FROM THE AMERICAN PEOPLE

RULE OF LAW PROGRAM IN ALBANIA

 **REPUBLICA E SHqipëRISE**
ILDKP
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TE PASURIVE

USAID DHE ILDKP MBËSHTESIN ROLIN E MEDIAS DHE SHOQËRISË CIVILE NË LUFTËN KUNDËR KORUPSIONIT



Faqe 2

KRIZA E FASONISTËVE DHE MUNGESA E REAGIMIT nga Bardhi Sejdarasi



Faqe 5-7




A INFLUENCON “KRIZA BOTËRORE” NË BIZNESIN KORÇAR?!...



Faqe 4

LUFTA KUNDËR INFORMALITETIT, PRIORITET EDHE NË VITIN 2009



(Intervistë me drejtorin e të Ardhurave në Bashkinë e Korçës
Z.PETRIKA TOLLKUÇI)

Faqe 3



USAID | RULE OF LAW
FROM THE AMERICAN PEOPLE PROGRAM IN ALBANIA



USAID DHE ILDKP MBËSHTESIN ROLIN E MEDIAS DHE SHOQËRISË CIVILE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT



KORÇA, 16 prill 2009, Programi i USAID-it për Shtetin Ligjor në bashkëpunim me inspektoriatin e Lartë të Deklarimit të Pasurive (ILDKP) organizuan në Korçë një workshop mbi Konfliktin e Interesave dhe Deklarimin e Pasurive. Ky është workshopi i katërt i mbështetur nga USAID dhe ILDKP që synon të rrisë njohuritë mbi ligjet që rregullojnë konfliktin e interesave dhe deklarimin e pasurive, si dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe median në zbulimin dhe denoncimin e rasteve të korrupsionit. Në workshop morën pjesë përfaqësues nga organizatat vendore të shoqërisë civile, gazetarë dhe zyrtarë të qeverisjes vendore të katër bashkive, komunave nga Pogradeci dhe Korça. Në fjalën e tij Z.Adriatik Llalla, Inspektor i Përgjithshëm i ILDKP, i njohu të pranishmit me rëndësinë e organizatave vendore dhe medias në promovimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë të zyrtarëve publikë. Në fjalën e hapjes Z.Sean Huff, Shef i Programeve të Zhvillimit të USAID tha se, Ambasada Amerikane në Shqipëri, nëpërmjet USAID-it, me kënaqësi i mbështet organizatat si ILDKP-ja në punën e tyre për një sektor publik më të përgjegjshëm dhe transparent. Z.Huff inkurajoi bashkëpunimin ndërmjet ILDKP-së, medias dhe shoqërisë civile për zbulimin e rasteve korruptive dhe të konfliktit të interesave. Programi i USAID-it punon me gjykatat, institucionet mbikqyrëse siç është ILDKP dhe organizatat monitoruese për të luftuar korrupsionin në sektorin publik në Shqipëri. Në workshop e morrën fjalën duke bërë pyetje e diskutuar: Z.Aurel Grabocka-Drejtor i ARZH-së Korçë, Z.Vehbi Furxhi-Botuesi i Gazetës të pavarur rajonale “Korça”, Z.Illir Shyta-TV “Sot 7” Pogradec, Klara Çelo-Kryetare e Shoqatës “Gruaja korçare”, Jorgjeta Gjançi-gazetare “Panorama”, Znj.Enina Face-avokate, Z.Albert Nasto-Kryetar i Shoqatës të Biznesit të vogël Korçë, Ergert Cenolli-gazetar, etj.



DEKLARIMI I PASURIVE DHE PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Kompetencat e ILDKP

Rol parandalues:

- Këshillimet e nevojshme për plotësimin e deklaratës si dhe njohja me rrjedhimet që mban deklarimi i rremë (neni 21 ligji 9049).
- Trajtimi dhe zgjidhja e K.I në fazën paraprake (neni 37, 38, 39 të ligjit 9367).

Rol ndëshkues:

- Kundrvajtje administrative
- Vëpra penale
- Pavlefshmëri aktesh e kontratash administrative
- Masa disiplinore.

Subjektet që mbartin detyrim për deklarim

- Zyrtarët me funksion të lartë shtetërorë
- Nëpunësit civilë të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues -Prefektet, Kryetarët e Këshillave të Qarqeve, Kryetarët e Bashkive dhe të Komunave.
- Prokurorët, gjyqtarët dhe përmbarnesit e të gjitha niveleve.
- Drejtesit, drejtoret dhe shefat në qendër e rajone të Policisë, të Tatimeve dhe Doganave dhe ata që merren me mbledhjen e të ardhurave tatimore e doganore.
- Drejtesit e të gjitha niveleve të kthim-kompesimit të pronave të privatizimit, regjistrimit të pasurive dhe të KRRT-ve.
- Zyrtarët që zgjidhen nga Kuvendi, Presidenti i republikës, Kryeministri, ministrat dhe personat e barazuar me ta.
- Drejtesit e Shoqërive anonime me kapital shtetëror mbi 50 % dhe me mbi 50 punëtorë.

Konflikti i interesit

- Konflikti i interesit është gjendja e interesit:
 - ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari.
 - në të cilën ai ka interesa private, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.
 - që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë.
 - në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.



Objekti i deklarimit

- Pasuritë e palujtshme dhe të drejtat reale mbi to.
- Pasuritë e luajtshme të regjistruara në regjistrat publikë.
- Sende me vlerë të veçantë mbi 5.000.USD.
- Vlera e aksioneve, letrat me vlerë dhe pjesët me kapital në zotërim.
- Vlera e likuiditeteve në lekë apo në valutë të huaj.
- Detyrimet financiare.
- Të ardhura personale për vitin dhe angazhime në çdo veprimtari.

Bashkëpunimi me publikun

- ILDKP e vlerëson aleat të rëndësishëm median shoqërinë civile e publikun në luftën kundër korrupsionit, për këtë arsye. ILDKP bashkëpunon me median, publikun e shoqërinë civile, pa diferencim.
- ILDKP mundëson informacion në një kohë shumë të shpejtë për të gjithë.
- ILDKP përparësi çdo të dhënë të ofruar nga media e publiku. ILDKP, shqyrton dhe heton çdo të dhënë të ofruar përmes numrit pa pagesë 0800999
- ILDKP, ruan konfidencialitetin e çdo burimi informacioni.

Kuadri ligjor

Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si një ndër institucionet kryesore në luftën kundër korrupsionit funksionon në bazë të:

Ligji nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”

Ligji nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Personat e lidhur me zyrtarin

Në kuptim të ligjit PKI rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në ligj janë:

Bashkëshorti/ja dhe prindërit reciprokë, fëmijët në moshë madhore (brenda dhe jashtë certifikatës familjare)

Ndalimi është i njëjtë si për vetë zyrtarin, por vetëm mbi aksionet apo pjesët në kapital.

Kufizim në lidhje me aktivitetin si person fizik tregtar.

Nuk ndalohen apo kufizohen aktivitete të tjera si dhe role drejtuese.



Z. Petrika Tollkuçi

Pyetje:-Si ka ecur regjistrimi i subjekteve të biznesit të vogël që kanë qënë të regjistruara prej vitit 2008 dhe sa është numri i subjekteve të reja të biznesit të vogël të regjistruar gjatë kësaj periudhe?

Përgjigje:-Bazuar në paketën fiskale të vitit 2009 të miratuar nga Këshilli Bashkiak, afati i fundit për kryerjen e pagesave në lidhje me tarifën e taksave lokale ishte data **31 mars 2009** për subjektet e biznesit të vogël që reregjistrohen dhe data për regjistrimin e subjekteve të reja në QKR (Qendra Kombëtare e Regjistrimit) përkon me datën e regjistrimit të këtyre bizneseve. Deri më 31 mars kanë ecur paralelisht të dyja proceset, edhe pagesa e taksave dhe tarifave lokale nga subjektet e biznesit të vogël që reregjistrohen dhe pagesa e subjekteve të biznesit të vogël që regjistrohen për herë të parë. **Deri më 31 mars 2009 ishin rreth 1700 subjekte të reregjistruara dhe 100 subjekte të reja.**

Pas datës **31 mars 2009** dhe deri në datën **21 prill 2009** është proceduar me shpërndarjen e urdhërpagesës të këstit të parë të taksës vendore për biznesin e vogël për vitin 2009.

Pyetje:-Si vazhdon lufta kundër informalitetit dhe çfarë masash janë marrë në këtë drejtim?

Përgjigje:-Në vazhden e një pune të nisur dy vjet më parë në **2007**, kur administrimi i subjekteve të Biznesit të vogël ka kaluar në Bashkinë e Korçës, përpjekjet e drejtorisë së të ardhurave, për të reduktuar informalitetin janë rritur dhe këtë e tregojnë rezultatet e këtyre dy viteve gjatë të cilave janë regjistruar për herë të parë **700 subjekte**. Ndihe në këtë drejtim ka dhënë dhe bashkëpunimi i ngushtë me shoqatën e Biznesit të vogël të kryesuar nga **Z. Albert Nasto**.

Ky bashkëpunim po forcohet dhe sofistkohet për vitin 2009 me prodhimin e **pullës identifikuese** për subjektet e biznesit të vogël të regjistruara të cilët **duhet ta afishojnë në vitrinat e subjekteve**. **Kjo pullë identifikuese është prodhuar me ndihmën e ARZH-Korçë** dhe po ju jepet subjekteve të biznesit të vogël në momentin e tërheqjes nga ana e tyre të këstit të parë të taksës vendore për vitin 2009 pranë Drejtorisë të të Ardhurave Korçë. Mbas datës **21 prill 2009 ka nisur verifikimi në teren**. Nëse këto subjekte e kanë vendosur këtë pullë, sepse qëllimi i vendosjes së saj është identifikimi i subjekteve informale që nuk e kanë kërë pullë.

Pyetje:-Shoqata e Biznesit të Vogël ka bërë disa kërkesa në Bashki, si janë plotësuar ato dhe si do të vazhdojë bashkëpunimi me shoqatën dhe ARZH-në?

Përgjigje:-Kërkesa e vazhdueshme e Shoqatës së Biznesit të Vogël ka qënë **lufta kundër informalitetit**. Në rezultatet e deritanishme janë dhe përpjekjet e përbashkëta me këtë shoqatë dhe ndërgjegjësimin e vetë subjekteve.

Një tjetër kërkesë e kësaj shoqate është **vendosja e orareve dhe e një dite pushime të bizneseve të vogla**. Në lidhje me këtë kërkesë është ngritur një grup pune i cili është duke përgatitur materialin përfundimtar të cilin do tua çojë për miratim Këshillit Bashkiak. Siç e përmenda dhe më lart këto rezultate të punës së drejtorisë së të ardhurave në Bashkinë e Korçës, nuk do të ishin të tilla pa bashkëpunimin e suksesshëm **me partnerët tanë të qëndrueshëm si ARZH-ja dhe Shoqata e Biznesit të Vogël në Korçë**.

Pyetje:-Taksat janë rritur, apo janë ulur, a do të ketë efektivitet në shpenzimin e të ardhurave që krijohen nga taksapaguesit korçarë?

Përgjigje:-Paketa fiskale 2009 e cila tashmë është bërë publike dhe në faqen e internetit të Bashkisë Korçë: (bashkiakorçë.gov.al) tregon qartë, **se nuk ka rritje të nivelit të taksave dhe tarifave vendore për subjektet e biznesit të vogël krahasuar me vitin 2008**, përkundrazi në këtë paketë i mëshohet dhe i jepet prioritet inisiativave të reja fiskale, si në numër dhe në llojshmëri të këtyre inisiativave. Një nga këto projekte që është bërë realitet është dhe kontributi që ka dhënë Bashkia për **10 subjekte të reja** të biznesit të vogël me një fond prej 130 mijë lek të reja për secilin.

Sigurisht që parimi i çdo buxheti është **balancimi i të ardhurave me shpenzimet**, por më tepër se kaq është **kanalizimi i këtyre të ardhurave të siguruara në ato drejtime të cilat do të gjallërojnë jetën e qytetit në përgjithësi dhe të biznesit në veçanti**.

Përsa i përket biznesit të madh edhe për këtë afati i fundit për taksat dhe tarifën lokale ka qënë data 31 mars 2009. **Ndryshe nga viti 2008, këtë vit një numër i vogël i biznesit të madh i kanë paguar taksat dhe tarifën lokale**.

Duke patur parasysh, që peshën e këtyre subjekteve të biznesit të madh është e rëndësishme në të ardhurat e Bashkisë Korçë **iu bëj thirrje që sa më shpejt të jetë e mundur të paraqitet në sportelet e drejtorisë së të ardhurave të Bashkisë Korçë për të marrë aktin e detyrimit për të paguar atë në një nga bankat e Korçës**.

Pyetje:-Cili është mesazhi juaj për subjektet e biznesit të vogël për vitin 2009?

Përgjigje:-Mesazhi im përmbledhet vetëm me një shprehje sinjifikative, duke e mbyllur këtë intervistë:-**NA NDIHMONI, T'JU NDIHMOJMË!**

-Ju faleminderit!

Intervistoi: Vehbi Furxhi

A INFLUENCON "KRIZA BOTËRORE" NË BIZNESIN KORÇAR?!...



-SOKOL DINELLARI:-President i Firmës së ndërtimit "SMAGINA"-Korçë
 -Ata që pretendojnë se "kriza botërore", nuk reflektohet në Shqipëri rrjedhimisht dhe në Korçë, sado pak qoftë ajo gabohen. Që të ndërtohet një apartament, në rradhë të parë duhet të kesh oferta, domethënë duhet të studiosh kërkesat e klientelës, të cilët duan të strehohen në apartamente bashkëkohore (1+2-2+1-3+1, etj), me kosto të ulët, e cilësi të lartë. Në këtë situatë, kur kriza botërore ka ardhur edhe tek ne vemë re, se ka një **ulje të kërkesave të klientelës, për blerje apartamentesh**. Pse?... Vështirësitë e klientit blerës janë, sepse **nuk ka lehtësira kreditimi, ka shumë procedura burokratike, të cilat pengojnë inisiativat për kreditim dhe blerje apartamentesh**. -Nga ana tjetër **normat e interesit nga Bankat** të cilat janë shtuar pafundësisht janë të larta. -Njerëzit kanë nevojë të ngutshme për strehim, por çështja qëndron tek burimi i të ardhurave, sepse **punësimi në rrethin e Korçës është i ulët**, si rezultat i mbylljes së një sërë biznesesh, një pjesë e tyre janë transferuar në Tiranë, a gjetkë si dhe mos hapjes së fronteve të reja të punës, nëpërmjet hapjes së bizneseve prodhuese, i cili punëson njerëz nga të gjitha shtresat. -Edhe **emigrantët** që punojnë jashtë shtetit, të cilët përbëjnë një klientelë të përhershme, ankohen për influencën e krizës në vendet ku ata punojnë, e cila shprehet në **mbylljen edhe atje të bizneseve** dhe daljen e këtyre emigrantëve në papunësi, si dhe në uljen e vlerës së pagesës për ditë pune të atyre emigrantëve të cilët janë punësuar, po kështu dhe rritja e koston së jetesës. Të gjitha këto bëjnë që kërkesat e klientelës të jenë jo si më parë, por më të ulta.

ARBEN SPAHO:-arkitekt

-Po! -"Kriza Botërore" influencon dhe tek biznesi korçar, si në gjithë Shqipërinë, sepse ne nuk jemi "jashtëtokësorë".
 -Kjo reflektohet përveç të tjerave dhe në sferën e ndërtimit, në uljen e ndjeshme të ndërtimeve, blerjen e banesave, rënien e kërkesave për leja ndërtimi në KRRT-në e Bashkësë dhe KRRT-në e Qarkut. Rritja e çmimeve të materialeve të ndërtimit influencon në koston, rrjedhimisht dhe në çmimin e blerjes së apartamenteve të banimit. **Në shitblerjen e apartamenteve ndikon shumë dhe taksa prej 10 %?!...**

Për taksën 10 % i marrëm mendim noteres Znj.KLEVA TABAKU:

-**Ç'është taksa e sheshtë 10 %?** Për këtë shpjegon Znj. Tabaku: -Është caktuar një tarifë minimum për tjetërsimin (shitje-dhurim) etj. të pasurive të paluajtshme për ndërtesa, troje etj. Për çdo transaksion që bëhet në një zyrë noteriale klienti është i detyruar të zbatojë çmimet që parashikon vendimi i Këshillit të Ministrave. **Mbi çmimin e shitjes është caktuar taksa 10 %**. Ajo mbahet nga shteti dhe derdhet në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Më parë kjo taksë varionte: deri në **2 milion lek të reja 0.5 %**, nga **2 milion deri në 4 milion lek të reja 1%** dhe nga **4 milion deri në 6 milion lek të reja 2%**, mbi çmimin e kontratës së shitjes. 10 %-shi llogaritet çmimi i shitjes - çmimin e blerjes, diferenca tatóhet **10 %**. Për shembull, në qoftë se 1 apartament do të shitet **6 milion lek të reja**, apartamenti i cili është blerë **2 milion lek të reja**, diferenca **4 milion lek të reja** do të tatóhet, dmth, do ti mbahet shitësit të apartamentit **400 000 lek të reja**.

-Pse ka rënë shitja e apartamenteve dhe trojeve?

1. Shteti dikton çmimet të cilat nuk përputhen me realitetin 2. Masa e tatimit prej **10 %** është shumë e lartë për ndërtesat dhe trojet, sidomos në fshat që tatimi **10 %** është i barabartë, ose pak më i ulët, se vlera e shitjes reale të kësaj pasurie ndërtese, ose trualli. 3. Përsa i përket dhurimeve, qoftë dhe brenda familjes tatóhesh, si për shitje, dmth, thirret një ekspert dhe në qoftë se, një apartament vlerësohet **4 milion** të reja i mbahen dhuruesit **400 000 lek të reja**, dmth tatóhet **10 %**. **Shitblerjet në fshat të shtëpive dhe të trojeve, por edhe në qytet kanë rënë 50 -70 %**.



GJERGJI SKLLAVI-President i Firmës "AK Konstruksion" Korçë"

-Kriza Botërore ë fushën e ndërtimit duhet parë në dy drejtime.

E para: -Në ndërtimin e banesave.

E dyta: -Në ndërtimet e tjera që bëhen me fondet e shtetit, ose të qeverisjes vendore, siç janë: shkolla-kopshte-rrugë-asfaltime-sistemime-sistemime blloqe banesash-banesat për të pastrehët, etj. -Përsa i përket **drejtim të parë**, atë të ndërtimit të banesave nga firmat dhe investitorët është sektori më i prekshëm nga kriza. **-Pse është më i prekshëm?** -Sepse bazohet në ligjin e kërkesës dhe ofertës. Kërkesat kanë rënë për banesa, sidomos nga klientët që janë jashtështetit, sepse kanë probleme me bankat dhe me të ardhurat e tjera që lidhen me punësimin dhe vlerën e ditës së punës, që është si më parë. Ky kontigjent ze mbi **30 % të klientelës**. Arsye tjetër është **kriza në sektorë të tjerë**. Kjo reflektohet në të ardhurat e klientelës. Legjislacioni në fuqi i miratuar vitin e kaluar rrit direkt çmimin e banesave, sidomos ligjin për shitblerjen e trojeve, ligjin mbi tatim fitimin **10 %**, etj. Edhe rritja e çmimeve të materialeve të ndërtimit influencon.

Drejtimi i dytë është ai që bëhet nga shteti dhe qeverisja vendore të materializuar na tendera. Në këtë drejtim kriza është e sfumuar, nuk është aq e dukshme, sepse jemi në vit zgjedhor dhe si zakonisht në vitet zgjedhore ka bum investimesh. Firmat që punojnë në tenderat janë të përzgjedhura nga pushteti qëndror dhe lokal. Këto firma të preferuara nuk e ndiejnë krizën, përkundrazi kanë fitime të majme, ndërsa të tjerat shihen si "të njerksës", e janë në vështirësi serioze dhe drejt falimentimit. Një problem shumë i rëndësishëm i cili është ngritur dhe në Shoqatën e ndërtuesve të Shqipërisë ka të bëjë me procedurat e liçensimit të firmave ndërtuese. Në bazë të këtij ligji tërë firmat që kanë punuar dy vitet e fundit marrin pikët maksimale për të hyrë në tender, në këtë mënyrë përjashohen firmat me eksperiencë të gjatë në ndërtim, duke preferuar ato me një eksperiencë të pakët. Për këto lloj firmash të privileguara nuk ka krizë, por ka "pranverë". Në lidhje me krizën duhet parë edhe në aspektin e teknologjisë së ndërtimit. Ndërtimet pa cilësi, pa teknologji bashkëkohore të cilat duhet të respektojnë kërkesat në rritje të njerëzve, shpihen detyrimisht në krizë sepse bie kërkesa. **L.F**



KRIZA E FASONISTËVE DHE MUNGESA E REAGIMIT nga Bardhi Sejdarasi-ekzkluzive për Gazetën "Vëzhguesi"

-Kur në muajt tetor-nëntor të vitit të kaluar filluan të duken shënjat e para të mungesës së punës në sektorin që punon me material porositi, zyrtarët e vlerësuan këtë si një dukuri kalimtare. Shifrat e qeverisë tregonin rritjen e eksporteve të Shqipërisë në drejtim të vendeve kontraktore. Por këto shifra u panë në tërësi, pa u ndaluar në sektorë të veçantë.

furnizohej me lëndë të parë.

-Në shkurt të këtij viti, Dhoma Kombëtare e Prodhuesve të Veshjeve (konfeksione dhe këpucë) i kërkoi qeverisë organizimin e një tryeze të rrumbullakët, për të diskutuar lidhur me dukuritë e shfaqjes së krizës edhe në vendin tonë. Qeveria vetëm dëgjoi ankesat e fasonistëve dhe vetëm mbajti shënim. Zëvendësministri i Financave iu tha në këtë kohë bizneseve të këtij sektori se "qeverisë i dhimbsej goftë edhe vetëm një punëtor i vetëm i pushuar nga puna". Kjo ishte një deklaratë ngushëlluese, kur kishin

sektor. Evidencat e kompanive tregonin të kundërtën. Vërtet raportohet numri i punonjësve të rregjistruar (për të mos humbur punëtorët e kualifikuar), por kishte mungesë likuiditeti për të paguar taksën respektive të punës (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore). Edhe ky tregues raportohet si i arritur nga qeveria në evidencat e drejtorive të tatimeve e taksave.

-Asnjë masë ndihmëse, asnjë lehtësi për të përballuar krizën që po importohet nga partnerët ndërkombëtarë, asnjë vendim në ndihmë të mbijetesës së kompanive që po detyroheshin të

stimuluese e favorizuese të përkohshme të qeverisë, të cilat janë kërkuar tashmë edhe zyrtarisht nga përfaqësuesit e biznesit fason të Shqipërisë, Dhoma Kombëtare e Prodhuesve të Veshjeve.

-56 kompani kanë shfaqur pamundësinë e sigurimit të lidhjes së kontratave të reja deri në fund të muajit mars 2009. Numri i kompanive që vazhdonin veprimtarinë ekonomike, por me ndërprerje dhe pushime periodike të punonjësve ishte sa dyfishi i kompanive të para. Bizneset raportuan

rrezikonin mbylljen dhe largimin e punëtorëve.

Korça u prek nga mungesa e punës dhe katër kompani raportuan mbylljen e aktivitetit ekonomik. Të tjera raportuan reduktimin e numrit të punonjësve deri në një periudhë të pacaktuar.

-Edhe pas kësaj panorame, qeveria nuk ndërmoi asnjë masë favorizuese për bizneset fasoniste, ndërkohë që pushteti vendor kishte rritur në mënyrë të menjehershme edhe taksat dhe tarifat vendore. Vendin e parë për këtë rritje e zinte Tirana, ku rritja sillet midis 30-

-Përfundimi? Sektori i fasonit, me rreth 470 ndërmarrje në të gjithë vendin, me rreth 66 mijë të punësuar drejtpërdrejt dhe mbi 40 mijë të tjerë indirekt, por që paguajnë të gjitha detyrimet ndaj shtetit, po ndjen pasojat e krizës: mungesën e kontratave, mungesën e likuiditetit për punën e kryer, humbjen e dhjetra mijë vendeve të punës, humbjen e punëtorëve të kualifikuar që, pas pushimeve sezonale të paralajmëruara, i kanë drejtuar sytë në sektorë të tjerë për të siguruar mbijetesën dhe ushqimin e familjeve të tyre.



Kështu u tha se eksportet u rritën rreth 15 %, por kjo ishte një rritje konjunkturale, që vinte vetëm si rezultat i rritjes së kërkesës dhe të çmimeve në tregun ndërkombëtar të metaleve me ngjyra dhe të mineraleve dhe jo të konfeksioneve e këpucëve, të cilat tregonin ulje në raport me periudhën paraardhëse.

-Biznesi i prodhimit të konfeksioneve dhe këpucëve ngriti zërin për t'i kujtuar qeverisë se ishte koha e lehtësive fiskale dhe ekonomike për mbijetesën e sektorit të prodhimit me material porositi. Kriza globale nuk kishte dhënë akoma ndikime në ekonominë shqiptare, por kjo krizë kishte filluar të shfaqej në vendet nga ku Shqipëria

filluar të mbylleshin ndërmarrjet e para që prodhohin për eksportet dhe kishte filluar të rritej ndjeshëm numri i punëtorëve të pushuar përkohësisht, apo përfundimisht nga puna.

-Por nuk ishte vetëm ky problem i fasonistëve. Kishte filluar të reduktohej numri i të punësuarëve, kishte filluar të mungonte lidhja e kontratave të reja me partnerët e huaj, por më problematike paraqitej gjendja e mungesës së likuiditetit të kompanive si rrjedhojë e moskorrëktësisë në pagesën kontraktuale të investitorëve të huaj.

-Qeveria vazhdonte të raportonte për rritjen e eksporteve dhe madje edhe për numër të njëjtë të punësuarish në këtë

mbyllnin dyert njëra pas tjetrës, nuk u ndërmorr nga qeveria.

-Rezultati? Në Tiranë raportuan pamundësinë për të vazhduar veprimtarinë e eksportit brenda një jave 6 kompani. E njëjta dukuri u vu re në Durrës, kur një kompani e huaj u largua përfundimisht nga Shqipëria. Në Berat, në Fier, në Vlorë, në Gjirokastrë, por sidomos në Korçë, numri i kompanive që rrezikonin mbylljen rritej çdo ditë. Nuk do të desha të përmend emrat e atyre kompanive që kanë deklaruar pamundësinë për mbijetesë në Korçë, me shpresën se do të mund të gjejnë së shpejti dritë në fund të tunelit. Por nuk është se ka shumë shpresë për mbijetesë edhe në Korçë, pa politika

pushimet e pjesshme nga puna, dhënien e detyrueshme të lejeve të zakonshme për punonjësit dhe paafësinë paguese nga tatim-taksat. Sipas të dhënave të raportuara në Dhomën Kombëtare të Prodhuesve të Veshjeve, vetëm për një muaj u shkurtuan rreth 1200 vende pune. Tirana, që rregjistron numrin më të madhe të të punësuarëve në këtë sektor, kishte edhe shkurtimet më të mëdha. Durrësi, po gjithashtu, por në këtë rreth bizneset treguan një solidaritet të spikatur dhe ato kompani që kishin kontrata dhe porosi nga jashtë vendit, ua shpërndanë atë në sasi të vogla kompanive të tjera që

300 % e tarifave të gjelbërimit e të pastrimit. Kjo i detyroi subjektet të kundërshtonin hapur këtë politikë taksash vendore, ndërsa qeveria reagoi me shumë vonesë, duke miratuar një projektligj që kufizonte rritjen më shumë se 10 % të këtyre tarifave, por tashmë subjektet kishin filluar të paguanin tarifën e rritura për t'i shpëtuar penaltiteve të ligjit, pas kalimit të afateve ligjore të pagimit të këtyre detyrimeve. Projektligji, ende i pamiratur, nuk ka efekte prapavepruese, kështu që dëmi ekonomik, në kushte krize, për bizneset e fasonit, është mjaft i konsiderueshëm. (Vijon në faqen 7)

-Qeverisë, që i "dhimbsej" goftë edhe një punëtor i papunë nga kriza, tani i duhet të rregjistrojë të papunët që po i shtohen përditë tregut të "Omonia-s". Dhe jo vetëm në Tiranë, por sidomos edhe në Korçë, ku investitorët janë sidomos nga shteti fqinj Greqia dhe ku diversifikimi i këtyre investitorëve mbetet një problem i madh për t'i shpëtuar falimentimit që vjen nga kriza e importuar e fasonistëve. A duhet reaguuar ndaj kësaj gjendje papërgjegjshmërie të Qeverisë?

BARDHI SEJDARASI
Drejtor Ekzekutiv
Dhoma Kombëtare
e Prodhuesve
të Veshjeve

ARZH-Korçë

FJALORI TREGËTISË ELEKTRONIKE

Në ndihmë të
biznesit!

Kjo është një përmbledhje e fjalëve që mund të ndeshni kur keni të bëni me tregëtinë elektronike. Ekspertët shpesh përdorin fjalë të pakuptueshme me qëllim që edhe çështje të thjeshta të duken të vështira dhe komplekse diçka që ju nuk mund të bëni pa to. Më poshtë ka disa nga ato terma që do t'i ndeshni në mënyrë të pandërprerë.	Download: kur ju transferoni informacion nga Interneti në kompjuterin tuaj.	Font: emërtimi një stili të tekstit.	Modem: një mjet që lejon një kompjuter të komunikojë me një kompjuter tjetër me anë të linjës telefonike.	ksionet e kartës së kreditit për një blerje.	Upload: transferim informacioni nga kompjuteri juaj në Internet.
Browser: program që ju lejon të lexoni informacionin dhe të udhëtoni në Internet: më të rëndësishmet janë Internet Explorer dhe Netscape.	E-commerce: ndërkohë që ka shumë përkufizime për tregëtinë elektronike, për ne thjesht do të thotë shitje mallrash dhe shërbimesh me anë të Internetit.	HTML: emri i gjuhës programuese të përdorur për të krijuar faqe Interneti. Programet shop building merret me këtë – dhe nuk ka nevojë përse ta dini.	Network: disa kompjutera të lidhur së bashku me qëllim që të informacion me njëri-tjetrin.	Redirect URL: një adresë Interneti që ju përket vetëm juve – dhe gjen faqe Interneti pavarësisht se ku janë në Internet.	URL – Universal Resource Locator: termi teknik për adresat e Internetit.
Domain Name: një adresë faqe interneti që u përket vetëm juve dhe i çon njerëzit direkt në faqen tuaj, kudo që të jetë në Internet.	E-mail: mesazh elektronik që dërgohet me Internet, i ngjashëm me një letër.	Internet: një rrjet i i gjerë botëror kompjuterik.	Online: kur ju keni një lidhje aktive me Internetin.	Search engine: një faqe Interneti që ju ndihmon të gjeni faqe të tjera në Internet.	Web host: një kompani që jep me qira hapësirë në Internet për t'ju lejuar të vendosni faqe në të.
Encryption: një proces në të cilin informacioni kriptonohet me qëllim që asnjë person i paautorizuar të mos e lexojë atë.	Merchant: dikush që shet mallra	Internet Service Provider: një kompani që ju jep akses në Internet.	PGP: program që kripton informacion të rëndësishëm me qëllim që të dërgohet në Internet në mënyrë të sigurt.	Shop building software: program kompjuteri që ju lejon të krijoni një dyqan për Internetin.	Web page: një "faqe" në rrjetin e gjerë botëror.
FTP – File Transfer Protocol: thjesht një metodë ku ju mund të ngarkoni dhe shkarkoni informacion nga dhe në Internet. Janë programe të specializuara që kryejnë këtë proces.	Merchant account: një llogari bankare që lejon njerëzit të pranojnë pagesa me kartë krediti.	Meta tags: informacioni veçantë i futur në faqet e Internetit i cili lejon mekanizmat e kërkimit të tregojnë dhe klasifikojnë më mirë faqen tuaj të Internetit.	PGP do të thotë pretty good privacy (fshehtësi e madhe) dhe ka të bëjë me kriptimet e ushtarake.	SSL: program i quajtur Secure Sockets Layer që kripton informacionin para se të dërgohet me anë të Internetit. Ai përfshihet në të gjithë browser-at.	Web site address: adresa për një faqe Interneti – kështu që ju mund ta gjeni atë në Internet me browser-in tuaj.
			Real – time payment service providers: një shërbim online që do të përpunojë për ju transa-	Traffic: sasia e informacionit që kalon nëpër Internet.	World Wide Web: të gjitha faqet e Internetit të kombinuara – përdoret edhe si term për Internetin.

ARZH-Korçë

SENSIBILIZIM!

-Agjensia Rajonale e Zhvillimit Korçë - në kuadrin e sensibilizimit të vazhdueshëm që ka ofruar nëpërmjet Gazetës "Vëzhguesi", ju tërheq vëmendjen të gjithë bizneseve të vogla në Korçë . Çdo biznes që në fillim të vitit të mbajë në mënyrë të rregullt faturat, mandatet, e tjera gjatë furnizimit me mallra të ndryshme, si dhe shpenzimet që parashikon ligji i ri për tatimin 10 % mbi fitimin për të mos ndodhur, si vitin e kaluar, ku pati mungesa në dokumentacion. Nga ana tjetër ARZH-me anë të specialistëve të saj, ofron konsulencë biznesi në mbështetje të Biznesit të Vogël.

-Ju falenderojmë për mirëkuptim!

**Drejtori:
Aurel Grabocka**

(Vazhdon nga faqja 5)



REFAT TUKE-Firma "Deal"-konfeksione me fason (me mall porositës)

-Firma jonë ka pasur 40 makineri (makina qepëse, etj, ku punonin 40 punëtorë. Kjo firmë ishte krijuar sipas rregullave që parashikon ligji me rroga të regullta, sigurime shoqërore dhe detyrime ndaj shtetit.

-Partneri ynë i huaj në bazë të kontratave dypalëshe, sipas ofert-kërkesës sillte mallin porositës (të prerë sipas kallëpëve) dhe firma jonë i qepte (pantallona, xhaketa, xhupa, xhinse, fustane, etj.) -Krizja botërore, unë mendoj, se ka influencuar përveç sektorëve të tjerë në Korçë në mënyrë të ndjeshme edhe në rrobaqepsitë të cilat punojnë me fason (me mall porositës).

-Mua më vinte malli, domethënë nga firma partnere e huaj i prerë sipas standarteve të kallëpëve dhe unë isha kontraktuar të bëj qepje me cilësi të lartë dhe pastaj rrobat e qepura, të hekurosura, të etiketuara dhe paketuara të niseshin tek partneri i huaj. Vitin e parë, domethënë, në vitin 2008, plotësuam kontratat reciproke, duke u paguar rregullisht për punën që bëmë nga partneri i huaj. Gjashtë muajt e fundit

filloj lëkundja, si mos pagimi i detyrimeve financiare nga partneri i huaj porositës, i cili filloi të hyjë borxh tek firma jonë. Nga ana tjetër edhe malli porositës filloi të mos vijë rregullisht dhe në sasi të kërkuara, gjë që solli që punëtorët e firmës sonë të mos punojnë me ngarkesë të plotë. Firma partnere e justifikonte këtë pa rregullsi me krizën botërore, si ngritje çmimesh, mosfurnizim metrazhesh dhe papunësi në shtetin e tyre dhe më gjerë, deri sa u arrit që në fund të gjashtëmuajorit firma porositëse më të mos dërgojë mall porositës, të jetë borxhli tek firma jonë. Kjo solli si rezultat që nga ana jonë të bëhen përpjekje për të gjendur partnerë të tjerë, por pa rezultat. Kështu u detyruam të mbyllim aktivitetin e robaqepsisë, të paguajmë punëtorët për punën që kishin bërë dhe ti nxjerrim në asistencë. Firma jonë është në pritje të krijimit të një situatë të re e të favorshme në të cilën ne kuptojmë shlyerjen e detyrimeve financiare nga firma partnere, dërgimi i mallit porositës dhe në pamundësi të kësaj do investigojmë gjetjen e partnerve të tjerë të rinj dhe rifillimin e punës nga punëtorët duke shpresuar edhe në zbutjen e krizës botërore. Edhe firmat e tjera me fason në Qarkun e Korçës, kush më pak, e kush më shumë kanë vështirësitë e tyre të cilat vijnë nga refleksionet e krizës botërore në Europë, në Korçë dhe në gjithë Shqipërinë.

TË DREJTAT E TATIMPAGUESVE

Për herë të parë në ligjin "Për procedurat tatimore", do të përfshihej edhe një kapitull i veçantë mbi "të drejtat" ku për çdo tatimpagues parashikohen të drejta të rëndësishme si;

- Çdo tatimpagues ka të drejtë që të marrë falas informacion për legjislacionin tatimor dhe ndihmë për zbatimin e tij, nga zyrat për shërbimin e tatimpaguesve;
- Çdo tatimpagues ka të drejtë që të trajtohet në mënyrë të paanshme, profesionale dhe etike nga administrata tatimore;
- Çdo tatimpagues ka të drejtë t'i ruhet konfidencialiteti për të dhënat e veta tatimore;
- Çdo tatimpagues ka të drejtë që të marrë njoftim për aktet administrative, veprimet ose mosveprimet për mbledhjen e detyrimeve tatimore, të cilat prekin pasurinë e tij;
- Çdo tatimpagues ka të drejtë që t'i bëhen nga administrata tatimore, në zbatim të kompetencave të saj, kontrolle të arsyeshme, në kohë të arsyeshme, në vendin e duhur dhe brenda afateve ligjore;
- Çdo tatimpagues ka të drejtë që të marrë përgjigje me shkrim kur ka mosmarrëveshje për një vlerësim tatimor të kryer në lidhje me arsyet, mënyrën e vlerësimit dhe vendimin e marrë;
- Çdo tatimpagues ka të drejtë që të marrë vërtetime nga administrata tatimore për të ardhurat e tatueshme, detyrimet tatimore të mbetura, si dhe pagesat e kryera prej tij, pas një kërkesë me shkrim, si dhe të kërkojë kopje të çertifikuara për çdo dokument në dosjen e tij tatimore, në rrugë elektronike apo shkresore;
- Çdo tatimpagues ka të drejtë që të emërojë një përfaqësues në marrëdhëniet me administratën tatimore;
- Çdo tatimpagues ka të drejtë që të ankimohet, të parashtrijë argumentet e tij përpara marrjes së një vendimi nga administrata tatimore për të dhe pasurinë e tij, si dhe të ketë një shqyrtim të pavarur administrativ në rast ankimi.

ARZH-Korçë

-Këshilli i Ideve:-

-Opinione për progres-

-”Jo rahje ujë në shoshë”, por punë konkrete të dukshme për progres



-Këshilli i Ideve ka shprehur nëpërmjet Gazetës “Vëzhguesi”, opsionet e saj konkrete të realizueshme përveç të tjerave dhe në Nr.26 të kësaj gazete, faqe 12-”Pazari i vjetër i Korçës, ose në Nr.27-”Korça nuk është vetëm qendra e qytetit, etj”

-Problemi thelbësor qëndron:-”A do të vazhdohet rrahje ujë në shoshë”, apo do të ketë punë konkrete të dukshme, e të prekshme nga qytetarët, të lodhur nga kjo periudhë 18 vjeçare e tranzicionit.

-Ka 18 vjet që flitet e bëhen Projekte nga vendas e të huaj, por ato deri tani kanë mbetur në letër, e nëpër sirtare, autorët kanë marrë honoraret nga të ardhurat e taksapaguesëve dhe na kanë lënë shëndenë, pa u bërë merak për realizimin e projekteve.

-Sikur çdo vit të ishte ndërtuar nga 1 rrugë me kalldrëm në zonën muzeale karakteristike, do të kishim sot 18 rrugë me kalldrëm, po kështu dhe 18 rrugë me asfalt. Gjendja që është

sot me rrugë me kalldrëm copë dhe rrugë me asfalt me arne, le shumë për të dëshiruar. Ku qëndron e keqja:-

1. Të mos bëjmë projekte për tu dukur, e të paralizueshme, por punë të studiuara dhe të realizueshme, dhe me cilësi të lartë, e jo si deri tani. Bëhen trotuaret, rrugët me asfalt dhe s’kalon 2-3 vjet dhe kërkohen fonde për tu bërë përsëri, që pas 2-3 vjet të kërkohen fonde për tu bërë përsëri nga e para. “Cuo vadis?!”...

2. Mendim qytetar, nuk do të thotë, mendim i disa njerëzve, që mund të jenë dhe pushtetarë, por që s’kanë ide dhe dëshirë realizuese konkrete.

-Mendim qytetar do të thotë mendim i intelektualëve të mirëfilltë korçarë, i çeljes së rubrikave në Median lokale e qëndrore të shkruar dhe atë radio-televizive, në bazë të një programi nga Këshilli Bashkiak, e Bashkia, ku të zhvillohen debate, e të jepen mendime racionale, nuk duhet të përdoren metodat përjashtuese e simpatitë personale, siç ka ndodhur deri më tani, mjaft me lavdërime dhe servilizma, jo më kot thotë populli.

-”Ai që të do, të kritikon”, ose sentenca e filozofit dhe ligjdhënësit grek Soloni, që thoshte:-”Kur mer pushtetin, mos mblidh rreth vete, njerëz të këqinj dhe të paaftë, se për tërë dështimet do të akuzojnë Ty.”

3. Janë nderuar në bazë të rotacionit politik të zgjedhjeve, shumë Kryetarë Bashkie dhe Këshilla bashkiake dhe bashkë me ta dhe një numër i madh nëpunës të aftë, të pa aftë, ose dhe korruptivë, por ekziston një koncept dhe pragmatizëm efektiv, që “stafeta të merret me një filozofi progresive në dobi të komunitetit, të merret nga paraardhësi pozitivja, racionalja dhe mbi atë “bazament” të vendosen gurët e tullat për ta ngritur më lart, më mirë, e më bukur godinën, sepse “gurë, gurë bëhet kalaja”, dhe jo çdo gjë të shihet me syze partiake, përjashtuese, bardhë e zi, me radikalizëm, e nihilizëm ekstrem.

-Të punosh për të hyrë në BE, në radhë të parë duhet të ndryshosh konceptet partiake, filozofinë e progresit në dobi të komunitetit, e cila të udhëheq pastaj në realizimin konkret të ideve. Le të shpresojmë të na kuptojnë!...

A.R.ZH. - Korçë

-

në bashkëpunim me

-

Gazeta “KORÇA”

PËRGATITI:

Art Design:

Laura Furxhi

Adresa:

Rr. „Ismail Qemali”-

Qendra e Biznesit

pranë Hotel „Grand ... kati i dytë

Tel.: 00355 82 242626

Fax: 00355 82 253977

e-mail: rda.korca@yahoo.com

Web: www.rda-korca.org

Adresa:

Rr. “Misto Mame” Nr.13 Korçë

Tel & Fax: 00355 82 242985

Tel: 00355 82 252460

Cel: 00355 682459546

e-mail: gazetakorca@yahoo.co.uk

Shtyp “KOTIP”